



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:050246

Datë: 04.04.2024

Numri i dokumentit: 05543919

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm, divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Dardan Maloku, me zyrtaren ligjore Ardita Tasholli, në çështjen penale ndaj të pandehurit A.E. me vendbanim në Rr.“....” në Ferizaj, për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 325 paragrafi 1 të Kodit 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës (tani e tutje KPRK-së), sipas Aktakuzës të paraqitur nga Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1569-6/2018 të datës 03.09.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, të hapur për publikun, më datë 07.03.2024, në të cilën kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Fatos Ajvazi, prokuror në Prokurorinë Themelore në Ferizaj dhe i pandehuri A.E. i sjellur në bazë të urdhër arrestit të datës 20.02.2024, më datë 07.03.2024, mori dhe publikisht shpalli, kurse më datë 04.04.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

A.E., nga i ati A. dhe e ëma S., e gjinisë S., i lindur më datë ..., në Ferizaj, me vendbanim në Rr. “....” me numër personal, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, me profesion mekanik, i pa martuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me datë 26.04.2018, rreth orës 20:30, në Rr. “....” në Ferizaj, me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja të luajtshme e që vetit ti sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm për vete, ka kryer vjedhje nga kamionët e të dëmtuarit N.L. dhe atë katër (4) bateri, një (1) targë e kamionit me numër 05-..., një (1) çelës për rrota, një (1) shufër metalike, dhe shtatëdhjetë (70) litra naftë,

vlera e dëmit të shkaktuar nuk është cekur nga i dëmtuari pasi që i pandehuri e ka kompensuar për naftën, ndërsa baterit i ka kthyer tek i dëmtuari.

-Me këtë ka kryer veprën penale **Vjedhje** nga 325 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 4 , 7, 8, 17, 21, 43, 45, 46, 49, 50, 51, 52, 73, 74 dhe 325 paragrafi 1 të KPRK-së, si dhe neneve 364, 452, 455 paragrafi 1 dhe 462 të Kodit të Procedurës Penale (KPP-së), të pandehurin e:

G J Y K O N

- I. Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet ne rast se gjatë periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, pasi aktgjykimi të marr formën e prerë, i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën gjykata do të revokoj dënimin me kusht dhe dënim me gjobë në shumën prej 200 (dyqind) euro, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguajë brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Nëse i pandehuri nuk mundet apo nuk dëshiron ta paguajë dënimin me gjobë, të njëjtit në pajtim me nenin 46 paragrafi 3 të KPRK-së, dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për 20 (njëzetë) euro gjobë të papaguara, i pandehuri do të vuajë 1 (një) ditë burgim.
- III. I dëmtuari N.L. me vendbanim në Rr. “....” në Kaçanik, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko –civil.
- IV. Obligohet i pandehuri në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 (njëzet) euro si dhe për fondin e kompensimit të viktimave të dhunës shumën prej 20 (njëzet) euro, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A R S Y E T I M

1.Rrjedha e çështjes dhe fjala përfundimtare

Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1569-6/2018 të datës 03.09.2018, ndaj të akuzuarit A.E., me vendbanim në me vendbanim në Rr.“....” në Ferizaj, për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 325 paragrafi 1 të KPRK-së.

Më datë 07.03.2024, është mbajtur seanca e shqyrtimit gjyqësor ku ka prezantuar prokurori i shtetit Fatos Ajvazi, prokuror në Prokurorinë Themelore në Ferizaj dhe i pandehuri A.E. i sjellur në bazë të urdhër arrestit të datës 20.02.2024.

Prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se: duke marr për bazë provat të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit kryesor me pa mëdyshje është vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprën penale sikurse në akuzë dhe kjo gjendje faktike është vërtetuar fillimisht nga dëshmia e të dëmtuarit N.L. i dëgjuar edhe si dëshmitar në shqyrtimin e datës 14.12.2021, i cili në tërësi ka përshkuar se si me datë 26.04.2018, në rrugën: “...” në Ferizaj në automjetin e tij transportues me targa 05-..., janë vjedhur katër bateri, një targë e kamionit, një qelës për rrota, një shufër metalike dhe 70 litra naftë, po ashtu dëshmitari ka vërtetuar faktin se si në fillim i njëjti nuk kishte ndonjë dyshim se kush e kishte bërë këtë veprim, kurse më vonë duke u interesuar për këtë rast kishte arritur që të kuptoj se rasti i vjedhjes kishte ndodhur pikërisht nga i pandehuri në këtë rast i cili i kishte rënë në gjurmë për të kontaktuar se pasi e kishte njoftuar të njëjtin i pandehuri kishte shkuar te parkingu i marketit “P.”, ku i pandehuri shkon aty me një veturë të tipit “Audi” me ngjyrë të zezë dhe ja dorëzon të dëmtuarit tri bateri dhe 50 euro para të gatshme si dhe tabelën e njërit kamion, e cila po ashtu ishte marr atë ditë në vendin e ngjarjes. po ashtu sipas dëshmitarit, i pandehuri i ishte lutur që i dëmtuari ti jep kohë dhe brenda javës do tia kthej edhe baterinë tjetër dhe 30 euro para të gatshme, por që këtij zotimit i pandehuri nuk i kishte qëndruar besnik. Dëshminë e të dëmtuarit se sendet e përshkuara me lartë i janë kthyer të njëjtit nga i pandehuri është vërtetuar edhe nga prova e administruar, respektivisht mbrojtja e të pandehurit e dhënë pranë zyrtarit policor me datë 18.05.2018, ku i pandehuri ka pranuar se ja ka kthyer bateritë dhe 50 euro para të gatshme, kurse më pas edhe targën e automjetit transportues, por që i pandehuri është mbrojtur në atë se këto gjëra i kishte blerë tek ”S.V.” ku kishte vërejtur tre persona duke shitur bateri të kamionëve, naftë, disa gjëra të tjera, ku sipas të pandehurit këto i kishte blerë në vlerën prej 50 euro, kurse sipas tij me rastin e kthimit të sendeve tek i dëmtuari momentin kur i është kërkuar kthimi i targës, i njëjti pohon se ka shkuar pikërisht në atë vend ku edhe i kishte blerë gjësendet, ku kinse sipas tij aty e kishte gjetur targën që ja kishte kthyer të dëmtuarit. Mbrojtjes së të pandehurit, gjykata nuk do të ia fal besimin në tërësi përveç fakteve që i pohon e që lidhën me kthimin e gjësendeve tek i dëmtuari, është jo për tu besuar se si ka mundësi që i njëjti ti këtë blerë këto gjëra në një vend ku është vend i cili frekuentohet nga shumë qytetar e aq më pak të jenë të ekspozuar gjësendet për ty shitur e që ato gjësende ishin të vjedhura, po ashtu është e pa besueshme se si ndodhi që

pas disa ditësh të blerjes së këtyre gjëseneve sipas të pandehurit i njëjti të shkoj përsëri në atë vend dhe të gjej targën e automjetit e cila i ishte vjedhur të dëmtuarit e me pas edhe ti kthehet këtij të fundit, i pandehuri duke u gjendur para këtyre fakteve të dëshmuara nga i dëmtuari nuk ishte rrugë tjetër por vetëm se i njëjti të shfrytëzoj të drejtën e tij ligjore dhe te mbrohet në heshtje, andaj si përfundim nga provat që i shtjelluan më lartë është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale Vjedhje nga neni 325 paragrafi, 1 të KPRK-së, andaj edhe i propozoj gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtor dhe ndaj tij duke marr për bazë rrethanat të cilat ndikojnë në matjen e dënimit në këtë rast si rrethana renduese shkallen e lartë të dashjes së të pandehurit, për ta kryer këtë vepër penale, faktin se me këtë vepër penale është cenuar e drejta për siguri në pronë e garantuar me kushtetutë, kurse sa i përket rrethanave lehtësuese përveç moshës së re që ka pasur i pandehuri në kohën e kryerjes së veprës penale nuk është gjetur ndonjë rrethanë tjetër, andaj mbi bazën e këtyre gjykata ndaj të pandehurit të shqiptoj dënim me burgim sepse vetëm me këtë lloj të dënimit mundë të arrihet qëllimi i dënimit.

I pandehuri në fjalën tij përfundimtare ka deklaruar se: nuk e ndiej veten fajtor, është e vërtet se sendet ja kam kthyer të dëmtuarit, mirëpo këto sende i kam blerë prej dikujt tjetër.

2.Provat e administruara

Në shqyrtim gjyqësor gjykata ka administruar provat si në vijim:

- Dëshmia e të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit N.L.;
- Si dhe janë administruar provat materiale: Deklarata e të pandehurit A.E. e dhënë në polici me datë 18.05.2018; Deklarata e të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit N.L. e dhënë në polici me datë 27.04.2018 dhe 16.05.2018; Raporti fillestar i incidentit i datës 27.04.2018; Raporti i oficerit i datës 27.04.2018.

2.1 Deklarata e të dëmtuarit - dëshmitarit N.L.

I dëmtuari - dëshmitari N.L. në dëshminë e tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se: ky rast ka ndodhur afërsisht para 3 viteve, ku dy kamionët e mi ishin të parkuar në në parking afër marketit “P.”, kur unë kam shkuar që t’i marr të njëjtit kam vërejtur se në të dy kamionët mungojnë bateritë e tyre, pra katër bateri dhe e tërë nafta e cila ka qenë në të dy kamionët, është marrë gjithashtu edhe tabela e regjistrimit të njërit prej tyre e cila më kujtohet se e ka këtë

numër 05-450-AF, ku vlera e këtyre baterive është nga 90 euro për çdo bateri, pas kësaj unë kam shkuar në stacionin policor që ta lajmëroj rastin sepse nuk e kam ditur dhe nuk kam dyshuar në askënd rreth këtij rasti, pasi që kam dhënë deklaratë në polici kam shkuar dhe kam blerë bateritë e kamionëve dhe naftën për to dhe i kam marr kamionët nga ai parking dhe kam shkuar në shtëpi. Të nesërmen personi me emrin N.L. i cili është punëtori im ka ardhur dhe më ka thënë se e din se kush i ka marrë nga kamionët e mi bateritë, naftën dhe tabelën dhe se ai këtë informatë e kishte marrur nga një shok i tij dhe se personi që i ka marrë sendet nga kamionët e mi quhet A.E., pastaj kërkova nga N. që të shkojmë në shtëpinë e A. që të merremi vesh pasi që i njëjti e dinte adresën ku ai jetonte dhe atë ditë kemi shkuar në shtëpinë e A.E.t e cila ndodhet në rrugën e fshatit ... afër “B.P.”. Kemi hyrë në shtëpinë e A. dhe aty ka dalur një person i cili është prezantuar si vëllau i A. sepse ai nuk ndodhej në shtëpi, pas kësaj N. e ka thirru në telefon A. i cili është lajmruar dhe nuk e ka pranuar se ai i ka marrë këto sende nga kamionët e mi, gjatë rrugës për në shtëpi unë prap e kam thirrur A. dhe i kam treguar kush jam dhe i njëjti e ka pranuar se i ka marrë sendet nga kamionët e mi siq e ceka më lart dhe jemi marr vesh që të takohemi po atë ditë në parkingun e marketit “P.”, ku edhe jemi takuar. Ju njoftoj se më herët nuk e kam njoftuar atë person deri atë ditë që jemi takuar në parking dhe është po i njëjti person i cili gjendet në sallë ulur në pjesën e djathtë timen (i akuzuari A. i cili ndodhet në vendin e të akuzuarit). Në parkingun afër marketit “P.” A. ka ardhur me veturën e tij “Audi” ngjyrë e zezë dhe më ka dorëzuar tre bateri dhe 50 euro para të gatshme si dhe tabelën e njërit kamion siç e ceka më lart, ndërsa një bateri dhe 30 euro para të gatshme më është lutur që ti jap kohë dhe brenda javës do mi kthej, unë jam pajtuar dhe i kam thënë se pasi ti pranoj të gjitha gjërat e mia do ta njoftoj policinë se nga ana ime me marrjen e sendeve është mbyllur ky rast, mirëpo i njëjti nga ajo ditë nuk është lajmëruar asnjër deri në ditën e sotme të shqyrtimit gjyqësor. Kur mi ka dorëzuar sendet A., prezent kan qenë dhe N.L. dhe B.L. dhe të njëjtit e kanë dëgjuar bisedën.

3. Mbrojtja e të akuzuarit

I akuzuari A.E., në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se e shfrytëzon të drejtën e mbrojtjes në heshtje në këtë çështje penale.

Kurse në deklaratën e tij të dhënë në polici e ka mohuar kryerjen e veprës penale duke theksuar se sendet të cilat ia ka kthyer të dëmtuarit i ka blerë nga persona të panjohur në rrugën “...” kurse targën e kamionit e ka gjetur pasi ka biseduar me të dëmtuarin dhe ka shkuar te vendi ku i ka blerë sendet dhe e ka gjetur.

4. Vlerësimi dhe analizimi i provave

Në seancat e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale gjykata bazuar në nenet 7 dhe 360 të KPP-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal dhe me përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarit si dhe ato në favor të tij duke i mundësuar të njëjtit shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë ka nxjerr përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara me ç'rast pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat janë administruar në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penalo juridike është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari e ka kryer veprën penale Vjedhja nga neni 325 paragrafi 1 të KPRK-së.

Raporti fillestar i incidentit i datës 27.04.2018 dhe raporti i oficerit i datës 27.04.2018, nuk janë prova që kanë peshë në vërtetimin e kësaj çështje juridiko-penale, të njëjtat janë të rëndësishme në konstatimin e veprimeve procedurale.

Gjykata ia fali besimin e plotë dëshmisë së të dëmtuarit – dëshmitarit N.L. pasi që dëshmia e tij përputhet me provat personale dhe materiale të administruara nga gjykata. Nga dëshmia e të dëmtuarit - dëshmitarit gjykata gjeti se i akuzuari A.E. pasi që është kontaktuar në telefon nga i dëmtuari e ka pranuar kryerjen e veprës penale dhe ia ka kthyer tre bateri dhe 50 euro para të gatshme si dhe tabelën e njërit kamion, ndërsa një bateri dhe 30 euro para të gatshme i është lutur që ti jap kohë dhe brenda javës do ia kthej, mirëpo nuk ia ka kthyer asnjëherë.

Gjykata ia fali pjesërisht besimin deklaratës së të pandehurit A.E. e dhënë në polici me datë 18.05.2018 dhe atë vetëm sa i përket faktit se i njëjti ia ka kthyer disa sende të dëmtuarit kurse pjesës tjetër të deklaratës nuk ia fali besimin sepse një deklaram i tillë nuk ka rrjedhë logjike e as kronologjike dhe është bërë vetëm për t'iu shmangur përgjegjësisë penale e sidomos pjesa e deklaramit të tij kur thekson se pasi që ka biseduar me të dëmtuarin ka shkuar tek vendi ku i ka blerë bateritë dhe e ka gjetur targën e kamionit. Po ashtu kur është marrë në pyetje i dëmtuari në shqyrtim gjyqësor i akuzuari A. ka pasur vërejtje në dëshminë e tij duke theksuar se nuk e ka takuar të dëmtuarin asnjëherë dhe nuk e njeh, kurse në deklaratën e tij të dhënë në polici ka deklaruar se *“në shtëpinë time ka ardhur një person dhe i kishte kërkuar bateritë...pasi vëllau më tregoi unë menjëherë i kam marrë bateritë dhe kam shkuar tek shtëpia e tij dhe ia kam dërguar bateritë dhe ia kam dhënë 50 euro...”*.

5.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri A.E. me datë 26.04.2018, rreth orës 20:30, në Rr. “...” në Ferizaj, me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja të luajtshme e që vetit ti sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm për vete, ka kryer vjedhje nga kamionët e të dëmtuarit N.L. dhe atë katër (4) bateri, një (1) targë e kamionit me numër 05-..., një (1) çelës për rrota, një (1) shufër metalike, dhe shtatëdhjetë (70) litra naftë, vlera e dëmit të shkaktuar nuk është cekur nga i dëmtuari pasi që i pandehuri e ka kompensuar për naftën, ndërsa baterit i ka kthyer tek i dëmtuari.

Neni 325 paragrafi 1 i KPRK-së përcakton se: *“1. Kushdo që personit tjetër ia merr pasurinë e cila vlerësohet në shumën prej pesëdhjetë (50) Euro apo më shumë, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet”*. Veprimi me të cilin kryhet kjo veprë penale është “marrja” e pasurisë së luajtshme nga personi tjetër (pronari apo mbajtësi). Marrja e pasurisë së luajtshme në kuptim të paragrafit 1 do të thotë ndërprerja e posedimit të pronës së luajtshme pa lejen e pronarit apo poseduesit (mbajtësit) dhe kalimi i pronës në pushtet të kryerësit të veprës apo në personin e tretë. Pra, është e nevojshme që të ndërpritet mundësia e disponimit faktik mbi pronën nga mbajtësi i mëparshëm dhe prona të vihet në pushtetin faktik të kryerësit apo me vullnetin e tij tek personi i tjetër. Andaj, marrjes si veprim i kryerjes përbëhet nga dy pjesë: 1) veprimi është i nevojshëm që të shkaktohet ndërprerja e posedimit (mbajtës) të një personi dhe 2) kalimi i posedimit tek personi tjetër të të njëjtës pronë (send). Në rastin konkret sendet e përshkruara në aktakuzë janë marrë (vjedhur) nga i pandehuri, ku është ndërprerë posedimi i të dëmtuarit dhe janë përvetësuar nga i pandehuri.

Andaj nga të gjitha të lartcekurat gjykata vërtetoi përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari A.E., ka kryer veprën penale Vjedhja nga neni 325 paragrafi 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të akuzuarit ti shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet ne rast se gjatë periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, pasi aktgjykimi të marr formën e prerë, i pandehuri nuk kryen veprë tjetër penale, në të kundërtën gjykata do të revokoj dënimin me kusht dhe dënim me gjobë në shumën prej 200 (dyqind) euro, të cilin dënim i pandehuri është i

obliguar ta paguajë brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të nenit 41 të KPRK-së. Gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 73 dhe 74 të KPRK-së, ashtu që rrethanë lehtësuese për të pandehurin ka marrë moshën e tij të re në kohën e kryerjes së veprës penale dhe faktin se i njëjti është mbajtës i familjes, kurse rrethana rënduese gjeti shkallën e lartë të dashjes nga ana e të pandehurit për kryerjen e veprës penale.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit mund të arrihen qëllimet e dënimit të parapara në nenin 41 të KPRK-së e që konsistojnë në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi lidhur më kërkesën pasurore juridike

Neni 462 paragrafi 2 i KPP-së përcakton se: *“Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mblidhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që tërë kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil apo të paraqes kërkesë në Programin për Kompensim të Viktimave nëse i plotëson kushtet e atij programi”* Andaj, pasi që nuk kishte një vlerë të saktë të kërkesës pasurore juridike dhe një veprim i tillë do ta zvarriste procedurën penale, gjykata duke u bazuar në dispozitën e lartcekur vendosi që të dëmtuarin për realizimin e kërkesës pasurore juridike ta udhëzoj në kontest të rregullt juridiko – civil.

8. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale, gjykata duke u bazuar në nenin 452 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që ta detyrojë të pandehurin që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzet) euro, si dhe duke u bazuar në nenin 36 paragrafi 3 nën

paragrafi 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109, për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumë prej 20 (njëzet) Euro.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
2018:050247, me datë 04.04.2024

Zyrtarja ligjor,
Ardita Tasholli

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Dardan Maloku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Ferizaj.